



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË**

---

Nr. 291 Prot

Tiranë, më 14.06.2021

**PROCESVERBAL**

Sot, më datë 14.06.2021, në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, u organizua takimi kryetarët e shoqatave të kineastëve, në të cilin morën pjesë:

Z. Genc Përmeti,

Z. Mevlan Shanaj,

Z. Ndriçim Xhepa,

Z. Jonid Jorgji.

Z. Pluton Vasi,

Znj. Sabina Kodra,

Qendra Kombëtare e Kinematografisë përfaqësohej nga:

Z. Eduart Makri, Kryetar;

Z. Arben Lami, Drejtor i Drejtorisë së Projekteve;

Znj. Shqiponja Dauti, Juriste.

Të gjithë kryetarët e shoqatave janë njoftuar për zhvillimin e takimit. Nuk morën pjesë:

- Z. Esat Z. Esat Ibro dhe z. Artan Maku.

Takimi ka këtë rend dite:

1. Diskutimi dhe përcaktimi i kriterëve për personat që do të kenë të drejtë për t'u regjistruar dhe çertifikuar nga QKK, për të votuar dhe zgjedhur KMP.

2. Diskutimi dhe përcaktimi i kriterëve të kandidatëve për anëtarë të KMP.

Pas diskutimeve të të gjithë të pranishmëve me shumicë votash u ra dakort sa më poshtë:

1. Të aplikohet procedura e propozuar nga Qendra Kombëtare e Kinematograafisë për zgjedhjen e Këshillit të Miratimit të Projekteve sipas parimit një anëtar, një votë.
2. Të drejtën e votimit në procesin e përzgjedhjes së Këshillit të Miratimit të Projekteve me mandat ligjor (Shtator 2021-Shtator 2023) ta kenë shtetasit shqiptarë që kanë kredite në filmat e metrazhit të gjatë të financuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë si më poshtë:
  - a. Skenarist;
  - b. Regjisor;
  - c. Producent.
3. Të drejtën e votimit në procesin e përzgjedhjes së Këshillit të Miratimit të Projekteve me mandat ligjor (Shtator 2021-Shtator 2023) ta kenë shtetasit shqiptarë që kanë kredite Regjisor në filmat e animuar të financuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.
4. Këshilli i Miratimit të Projekteve të ketë këtë strukturë:
  - a- 3 (tre) anëtarë/anëtare me shtetësi të huaj, të cilët duhet të plotësojnë këto kriterë:
    - 1 (një) anëtar/anëtare i cili të jetë Regjisor, Producent;
    - 2 (dy) anëtarë/anëtare, të cilët duhet të jenë Skenaristë.
  - b- 2 (dy) anëtarë/anëtare me shtetësi shqiptare, të cilët duhet të plotësojnë këto kriterë:
    - 1 (një) anëtar/anëtare të jetë Regjisor;
    - 1 anëtar/anëtare të jetë Producent, ose Skenarist.
5. Të drejtën për të kandiduar si anëtar/anëtare e KMP e kanë personat që plotësojnë, apo i përfaqësojnë më shumë kriterëve të më poshtme:
  - Të ketë realizuar jo më pak se tre filma artistikë, nga të cilët një të jetë pranuar në konkurim zyrtar në një festival kompetitiv (kategoria A);

- Të kenë mos kenë precedentë penalë, apo civilë;
- Të kenë një figurë të pastër etike.


6. Pas procesit të aplikimit, do të përzgjidhen në bazë të kriterëve 6 (gjashtë) kandidatura me shtetësi të huaj dhe (4 katër) kandidatura me shtetësi shqiptare.

7. Personat që kanë të drejtë votimi sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 do të përzgjedhin 3 (tre) anëtarë me shtetësi të huaj (njëri të jetë me kombësi shqiptare) dhe 2 (dy) anëtarë me shtetësi shqiptare.

Ndriçim Xhepa 

Genc Përmeti 

Sabina Kodra 

Mevlan Shanaj   
Për pikën 4 votoj kundër

Pluton Vasi 

Jonid Jorgji 

Eduart Makri 

Arben Lami 

Shqiponja Dauti 

Ky procesverbal nënshkruhet në 3 kopje origjinale.